



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 03

Datë: 27.01. 2023. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

-Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr. 44/2022 dhe 01/2023

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së

• Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së rreziqeve dhe plani i vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut në KQZ

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për zbatimin e Planit të punës së KQZ-së për vitin 2022

• Këshilli për Personel

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për angazhimin e stafit shtesë: për anëtarin e KQZ-së z. Kurtishi, kërkesa e Udhëheqësit të Divizionit për Personel dhe Shërbime të Përbashkëta si dhe kërkesa e Drejtorit të Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike.

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të rekrutimit për vitin 2023

• Këshilli për Buxhet dhe Financa

-Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

- **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

-Njoftim nga A-ËEB: “Kërkesë nga Organizata e Zgjedhjeve të Kolumbisë për bashkëpunim në anketën e anëtarëve të Trupave Menaxhuese Zgjedhore”.

-Rekomandim për vëzhgimin e zgjedhjeve sipas kalendarit të zgjedhjeve për vitin 2023.

- **Komiteti i Auditimit**

-Njoftim për Raportin e Punës të Komiteti të Auditimit të Brendshëm

Të ndryshme

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Fillimisht, kryetari Radoniqi i përshëndeti anëtarët e KQZ-së, dhe njoftoi se anëtarët Ibrahim Selmanaj dhe Fazli Stollaj nuk do të mund të jenë të pranishëm. Pastaj, ai e paraqiti agjendën e takimit dhe pyeti nëse ka vërejtje, sugjerime, propozime...! Mbasi që nuk kishte, anëtarët e pranishëm me 8 vota për, miratuan rendin e ditës.

Lidhur me miratimin e procesverbalit nr. 44/2022, z. Kurteshi tha se te rekomandimet për zëvendësim të asamblistëve, tha se është ber gabim te “zëvendësimet” dhe se bëhet fjalë për asamblistë të VV-së. (të përmirësohet në tekstin e prc. Nr. 44...). Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së me 8 vota për, miratuan edhe dy procesverbalet nr. 44/2022 dhe 01/2023.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, krye shëf i Sekretariatit e informoi KQZ-në për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok si dhe zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin Komunal do të mbahen më 23 prill 2023, tha se është kërkuar nga secili departament dhe njësi përgjegjëse të draftoj aktivitetet që do të përfshihen në planin operacional në përputhje me zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe të parakohshme të cilat duhet të mbahen brenda 30-45 ditësh.

Afatet duhet të rrjedhin nga data 09 mars 2023. Në planin operacional, duhet të përfshihen edhe aktivitetet e ZRCKFSP. Përgjegjës për këtë plan, është drejtori i DOZ –it, Haki Krasniqi, për aspektin teknik është u.d i udhëheqësit të Shërbimit Votues z. Premtim Rustemi dhe përgjegjës për monitorimin e aktiviteteve është zv. KE-SKQZ z. Xhemail Peqani.

Kryeshefi Ahmetaj, tha më tutje se në kuadër të planit të punës së KQZ-së është aktiviteti nr. 15, ngritja e kapaciteteve të stafit të KQZ-së, që ka për qëllim ngritjen e kapacitetit të stafit. Aktiviteti do të zhvillohet gjatë tërë vitit dhe në fund duhet të përgatitet raport të trajnimeve të mbajtura. Për këtë vit, janë 18.800 euro në buxhet për trajnime dhe ngritje të kapaciteteve. Sipas propozimit të koncept dokumentit lidhur me trajnimet, një komision do t'i kontaktoj të gjithë zyrtarët dhe do të identifikohen nevojat e trajnimit Brenda Sekretariatit.

Po ashtu, tha z. Ahmetaj, në planin e punës së KQZ për vitin 2023, është edhe aktiviteti nr. 23 “Rishikimi i specifikave teknike për materialet zgjedhore” (furnizime dhe shërbime). Ndërsa, nga Njësia e Auditimit të

Brendshëm në SKQZ, një ndër pikat që është audituara, është “Furnizimi me distinktiv” dhe në bazë të të gjeturave, është rekomanduar rishikimi dhe thjeshtimi i specifikave të furnizimi me distinktiv. Kështu, edhe e kemi formuar komisionin për rishikimin e specifikave teknike për furnizim me distinktiv.

Gjithashtu, një aktivitet tjetër, procesi i regjistrimit të pasurisë jo financiare për vitin 2022, tani është kompletuar në muajin janar 2023, dhe Sekretariati është në fazën e vlerësimit ku ka formuar komision për vlerësimin e pasurisë jo financiare për të vlerësuar vlerën e të gjithë pasurisë jo financiare të KQZ-së dhe statusin e tyre që mund të jenë në përdorim dhe jashtë përdorimit. Procesi i vlerësimit të pasurisë jo financiare, do të përmbyllet në mesin e muajit mars 2023, kur edhe do të trajtohet raporti, fillimisht në Menaxhmentin e Sekretariatit, dhe pastaj në KQZ.

Siç, e dini, tha Ahmetaj, në vitin 2022, KQZ ka miratuar Udhëzimin Administrativ të KQZ-së Nr.02/2022, për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare të KQZ-së, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së dhe në bazë të të cilit ka zhvilluar procedurat për donimin e pajisjeve Tabletë PC për organizata të ndryshme. Dhe më 26 janar 2023, KQZ ka dhuruar tek organizatat jo qeveritare gjithsej, 812 Tabletë PC.

Në vazhdim, u raportua me radhë lidhur me organizatat, dhe numrin e tabletëve të dhuruar:

1. *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhuron tetëdhjetë (80) Tabletave PC –Prestigio në formë të (donacionit) Organizata Jo-Qeveritare (OJQ) Balkan Sunfloëers Kosova (BSFK) - përfaqësuar nga z. Muhamet Arifi, Drejtor Ekzekutiv, Rruga “Bajram Kelmendi” 31, Prishtinë;*
2. *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhuron dyqind e katër dhjetë e dy (242) Tabletave PC –Prestigio në formë të (donacionit) Shoqatës “Handikos” - përfaqësuar nga z. Afrim Maliqi, Rr. Dardania 4/7, lamela D-2, Prishtinë;*
3. *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhuron gjashtëdhjetë (60) Tabletave PC –Prestigio dhe dhjetë (10) Tabletave Vivax në formë të (donacionit) Organizata Jo-Qeveritare (OJQ) “Ruka Ruci”- përfaqësuar nga znj. Gordana Toskic, Drejtoresh e OJQ-së, Grçanicë;*
4. *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhuron njëzetë (20) Tabletave PC –Prestigio dhe gjashtëdhjetë (60) Tabletave Vivax në formë të (donacionit) Organizata Jo-Qeveritare Fuqizimi i Gruas dhe Rinisë (FGRS) - përfaqësuar nga znj. Saranda Bajraktari, përfaqësuese e autorizuar, Komuna Suharekë;*
5. *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhuron tetëdhjetë (80) Tabletave PC –Prestigio në formë të (donacionit) Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave (QPDG) - përfaqësuar nga znj. Kadire Tahiraj, Drejtoresh Ekzekutiv, Rr. Xhevë Ladrovci- Ish Objekti Komunës-Drenas;*
6. *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhuron tetëdhjetë (80) Tabletave PC -Prestigio në formë të (donacionit) Qendra Rinore Youth Center - përfaqësuar nga znj. Zelushe Kelmendi, Drejtor, Rr. “ Hasan Prishtina” Obiliq;*
7. *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhuron tetëdhjetë (80) Tabletave PC -Prestigio në formë të (donacionit) Shkolla Filllore e Mesme e Ultë “Luigj Gurakuqi (SHFMU)” Sankocë-Glllogoc përfaqësuar nga z. Emin Isufi – Drejtor;*
8. *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhuron njëqindë (100) Tabletave PC -Prestigio në formë të (donacionit) SOS Fshatrat e Fëmijëve – përfaqësuar nga znj. Nezahat R. Salihu, Drejtor Nacional Zyra Kombëtare 1 Tetor p.n. Velani, 10000 Prishtinë.*

Në raportin e paraqitur në mes të dy mbledhjeve, KQZ u informua për punën që është duke u bërë në hartimin e planit strategjik të KQZ-së për vitin 2023-2026. U raportua se, është hartuar “Misioni, Vizioni, Parimet orientuese, Analiza SËOT, Shtyllat dhe synimet strategjike” të planit, ndërsa janë në radhë për tu hartuar “veprimet strategjike, objektivat dhe aktivitetet”.

Në fund, krye shefi Burim Ahmetaj, tha se nëngrupi punës i caktuar, do të menaxhojë procesin dhe do t'i hartojë objektivat dhe aktivitetet sipas strategjisë, në mënyrë që të kompletohet ky plan. Lidhur me identifikimin, materializimin dhe përgjegjësitë e objektivave strategjik janë përcaktuar 5 shtylla strategjike. Dhe, po ashtu, janë emëruar edhe përgjegjësit e tyre.

Ndër aktivitetet në vijim e sipër, z. Ahmetaj përmendi: 1. Rregullat Zgjedhore – rishikimi final; Organizimi për shënimin e Ditës Globale të Zgjedhjeve që do të mbahet me 2 Mars 2023; Përgatitja e planit për angazhimin e stafit jo permanent për këto zgjedhje, zhvillimi i procedurave për furnizime dhe shërbime për këto zgjedhje; Raportimi i obligimeve të papaguara; Tjetërsimi i pasurive jo financiare të KQZ-së nëpërmjet shitjes dhe donimit; Përgatitjen e Raportit të kontratave të lidhura për vitin 2023.

Sami Kurteshi, shtroi pyetje rreth pasurisë jo financiare, meqë siç tha po vie kah fundi se, çka do të bëhet me atë pasuri që ma nuk ka asnjë vlerë, e që janë të zënë hapësirat...? A do të ndërmerren masa, a do të lirohen hapësirat që për arsye burokratike mbeten të zëna... Po ashtu, ai shtroi një çështje: furnizimi i KKZ-ve, siç tha ai, “me 24 paketa me ujë” në Dragash, e që kostoja është shumëfish më e shtrenjtë se sa kushtojë uji...? Duket banale, por...

Arianit Elshani, tha se “për falsifikim të votave në 2017 është dënuar një person” ! Dua të di, pyeti z. Elshani, nëse ky rast është iniciuar nga KQZ, pra a është pranuar vendim nga gjykata...? Ai tha se, është mirë që të njoftohemi si anëtarë të KQZ-së me vendimet e gjykatave...

Lidhur me këtë pyetje të z. Elshani, diskutoi edhe z. Kurteshi dhe tha se, duhet njoftuar edhe KQZ.

Burim Ahmetaj, tha se në mbledhjen e ardhshme do të njoftohet KQZ me këtë rast, kurse rreth vlerësimit të pasurisë jo financiare, lirimit të hapësirave tha se, do të identifikohet gjithë pasuria dhe që do të gjenden forma për lirimin nga pasuria që e ka vlerën zero...

Kryetari Radoniqi, tha se kemi diskutuar që ta kemi një “Databazë” të këtyre çështjeve...!

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së

1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së rreziqeve dhe plani i vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut në KQZ:

Arianit Elshani: KOZ e ka shqyrtuar listën dhe planin. Kjo ka qenë edhe rekomandim i auditorit në të kaluarën. Si dokument, është i përfunduar gjatë vitin e kaluar prandaj, s’arritëm ta miratojmë në dhjetor. Ky dokument, është i detajuar, i përmban ka rekomandimet kundrejt rreziqeve dhe elementet e planit janë shqyrtuar kështu që, KOZ vlerëson të miratohet...

Anëtarët e KQZ e miratuan me 8 vota...

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për zbatimin e Planit të punës së KQZ-së për vitin 2022:

Arianit Elshani, tha në vazhdim se KOZ, nuk ka pasur mundësi ta shqyrtoj për shkak të mungesës së kuorumit prandaj, kërkoj që drejtpërdrejtë ta miratoni këtë raport, meqë raporti është hartuar duke u diskutuar dhe bashkëpunuar me çdo njësi, departament etj. Nga 58 aktivitete, 47 janë realizuar disa tërësisht dhe disa pjesërisht ! Rekomandoj të miratohet: këtu, është puna e jonë e vitit të kaluar që ka qenë mjaft intensive...

Anëtarët e KQZ e miratuan me 8 vota...

2. Këshilli për Personel

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për angazhimin e stafit shtesë për anëtarin e KQZ-së z. Kurtishi, kërkesa e Udhëheqësit të Divizionit për Personel dhe Shërbime të Përbashkët, a si dhe kërkesa e Drejtorit të Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike:

Arianit Elshani (në mungesë të përfaqësuesit të këtij këshilli), tha se është shqyrtuar kërkesa për angazhimin e stafit shtesë për anëtarin e KQZ-së z. Kurtishi, kërkesa e Udhëheqësit të Divizionit për Personel dhe Shërbime të Përbashkët, e po ashtu, edhe kërkesa e Drejtorit të Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike. Ne, konsiderojmë se këto pozicione janë të nevojshme për Sekretariat. Dhe ne, rekomandojmë që në plotëni të miratohen këto kërkesa...

Anëtarët e KQZ i miratuan me 8 vota kërkesat e rekomanduara nga Këshilli për Personel.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të rekrutimit për vitin 2023:

Arianit Elshani: Këshilli për personel e ka shqyrtuar edhe planin e rekrutimit për vitin 2023, dhe në kuadër të planit janë të listuara pozicionet e lira...! Këto vende, duhet të plotësohen gjatë këtij viti. Si këshill, kemi vlerësuar se disa pozita që janë këtu, në KQZ në qendër, ti lëmë për më vonë sepse, jemi ende në shqyrtim të rregulloreve, siç është edhe rregullorja e rekrutimit, sistemimit dhe e gjithë procesit të këtillë... Ndërsa, sa u përket zyrtarëve të lartë komunal ku kemi disa vende, në afatin sa më të shkurtër të hapet procesi i rekrutimit...

Sami Kurteshi, tha se njësia e Auditimit e kërkon edhe një person dhe kjo është me ligj. Pra, këtu duhet hapja e një pozite të re, sepse është çështje ligji...

Sami Hamiti, tha po ashtu se, edhe zyrtari financiarë është i paraparë por s'ka buxhet. Rekrutimi, s'mund të bëhet pa ndarje të buxhetit, pra zyrtarisht kjo duhet të kërkohet... Të bëhet kërkesa, pra vazhdoni me procedura sipas planit...

Anëtarët e KQZ i miratuan me 8 vota kërkesat e rekomanduara nga Këshilli për Personel.

3. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022:

Gordana Llaban: Sot, në takimin që patëm kemi shqyrtuar katër pika, por pika më e rëndësishme ka qenë ajo për raportin vjetor financiar për vitin e përfunduar 2022. Bazuar në rregullat dhe ligjet aktuale, raporti thekson se buxheti i KQZ për këtë vit ka qenë 6, 240, 132 euro. Prej këtij buxheti, KQZ ka shpenzuar 5, 617, 810 euro.

Kryesuesja e këtij këshilli, pasqyroj shpenzimet e bëra sipas planit të shpenzimeve...

Sami Kurteshi, tha se, kemi problem me shfrytëzimin e mjeteve kapitale, sidomos të trajnimeve! E dyta, po pyes “rreth shpenzimeve kapitale”, një shifër...

Në këtë pikë, rreth raportit, diskutuan, shtruan pyetje, bënë shqyrtime, analiza etj.: Arianit Elshani, Kreshnik Radoniqi, Sami Kurteshi dhe Sami Hamiti.

Në fund, anëtarët e KQZ e miratuan me 8 vota për raportin financiar të KQZ-së për vitin 2022.

4. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Njoftim nga A-ËEB: “Kërkesë nga Organizata e Zgjedhjeve të Kolumbisë për bashkëpunim në anketën e anëtarëve të Trupave Menaxhuese Zgjedhore”:

Burim Ahmetaj, e informoi KQZ-në lidhur me një ftesë nga AËEB, lidhur me bashkëpunimin dhe plotësimin e një sondazhi. Kërkesa e tyre, është lidhur me një dokument – projekt që u drejtohet trupave zgjedhore në shtete të ndryshme...Janë disa pyetje që, kërkohen përgjigje...

Rekomandim për vëzhgimin e zgjedhjeve sipas kalendarit të zgjedhjeve për vitin 2023:

Burim Ahmetaj, e informoi KQZ lidhur me “kalendarin e zgjedhjeve 2023” që e publikon NDI. Ai, i informoi anëtarët e KQZ-së lidhur me prioritetet, nevojat e vëzhgimit, dhe natyrën e zgjedhjeve në disa shtete evropiane, përfshirë edhe Turqinë.

AI, tha se këtë e vlerëson dhe e shqyrton KQZ, dhe merr vendim për ose, jo në zgjedhjet e ndryshme që mbahen këtë vit...

Kreshnik Radoniqi, tha se këto çështje janë diskutuar edhe në takimin e Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë ! Si ja bëjmë, për ku do të përcaktohem...?

Ilir Gashi, tha se së pari, do të duhej vënë kontaktet: ku, pse...? Ne, mund të shqyrtojmë kriteret, mbase nuk kemi urgjencë veç Koresë... Në parim pajtohemi, por kemi kohë...

Arianit Elshani, tha se, mirë është që po diskutojmë dhe, ne duhet ta kemi një “dokument” tonin që ta vlerësojmë “kalendarin:, ku, pse kemi nevojë...

Burim Ahmetaj, tha se “Estonia” është paksa më urgjente sepse, atje janë zgjedhjet më 5 mars...

Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ –së në zgjedhjet në Koren e Jugut

Burim Ahmetaj: Një pikë është “Kërkesë e shprehjes së interesit” ...! Kemi pranuar gjatë ditës një, në fakt dy i mella nga z. Arianit Elshani, anëtar i KQZ-së. Në miellin e tij, kanë ardhur kërkesa... Bëhet fjalë për zgjedhje në Koren e Jugut në prill 2024, por para zgjedhjeve ata organizojnë dy trajnime dhe qeveria koreane, do të jetë organizatore. Pra, në AËEB kërkohet që anëtarët e saj, të shprehin interesin por, administravisht kjo është më urgjente...Pra, KSH i Kores së Jugut, sponsorizon dy trajnime...

Janë dy trajnime...

Kreshnik Radoniqi: Pajtohemi që kemi interes...veç, mos e leni që para datës 31 prill të procedohen çështjet...

Komiteti i Auditimit

Njoftim për Raportin e Punës të Komitetit të Auditimit të Brendshëm:

Sami Kurteshi, kryesues i Komitetit të Auditimit tha se, KO ka ba përpjekje të punojë 2022. Ne, kemi mbajtur pesë takime, një më shumë se takimet e parapara; Kemi bërë disa veprime, hartimin e disa dokumenteve të punës, një plan për vitin 2023; trajtimin e planit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, zbatimin e tyre...Pjesëmarrja në takim ka qenë e mirë, përfshi edhe pjesëmarrjen e kryeshefit; E kemi hartuar edhe planin vjetor, dhe atë strategjik...

Z. Kurteshi, paraqiti edhe çështjet e tjera që lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komitetit, përfshi edhe nevojën me ligj të angazhimit edhe të një zyrtari gjatë këtij viti...

Arianit Elshani, tha se “e vlerësoj punën e bërë të KO”, por në raport “tetë rekomandimet” e dhëna të auditorit të brendshëm, gjashtë rekomandime mbeten të pa adresuara por, ne presim që këto të adresohen, të listohen, pra ne të informohemi...

Sami Kurteshi, po rekomandimet janë për Sekretariatit, dhe ne mund ta bëjmë një “listë” dhe t’ua dërgojmë...

Në vazhdim të mbledhjes, u diskutua edhe lidhur me “reformën zgjedhore”, “me rregulloret e brendshme”, si dhe përcaktimi i ditëve për mbajtjen e punëtorisë...

Diskutuan: Arianit Elshani, Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Kreshnik Radoniqi dhe Burim Ahmetaj.

Në fund, u vendos që punëtorja të mbahet 12 – 16 shkurt, 2023.

Të ndryshme !